



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada - Government**

**Zyra e Kryeministrit -Ured Premijera -Office of the Prime Minister**

**Agjencia e Statistikave të Kosovës - Agencija za Statistiku Kosova - Kosovo Agency of Statistics**

Bazuar në nenin 8 pika 3.1, nenit 6 pika 5 dhe nenit 33 të Ligjit Nr.04/L-036 për Statistikat Zyrtare të Republikës së Kosovës, Udhëzimit Administrativ Nr.08/2012 për kushtet dhe Mënyrën e Ofrimit të Dhënave të Fituara me Përpunime të Veçanta të Statistikave Zyrtare si dhe nenit 12 paragrafi 4 të Ligjit Nr. 03/ L -149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ligjin Nr. 04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve, **Agjencia e Statistikave të Kosovës** bënë:

**Shpalljen e Konkursit Publik për Marrëveshje për Shërbime të Veçanta**

Emri i Institucionit	<b>Agjencia e Statistikave të Kosovës</b>
Titulli i punës:	<b>Anketues/Intervistues për grumbullimin e të dhënave të arsimit tek shkollat serbe (Gjilan dhe Ferizaj)</b>
Numri i referencës:	<b>ASK-DSS-001</b>
Tarifa e shërbimit:	<b>Pagesë fikse 250€ bruto</b>
Raporton te:	<b>Zyra Rajonale: Gjilan dhe Ferizaj</b>
Lloji i kontratës:	<b>Marrëveshje për Shërbime të Veçanta-(MSHV)</b>
Kohëzgjatja e kontratës:	<b>Një (1) muaj</b>
Orari i punës:	<b>I plotë</b>
Lokacioni dhe numri i ekzekutuesve:	<b>ASK- 2</b>

### **Detyrat dhe përgjegjësitë:**

- Të marrin pjesë në trajnime dhe të njihen me Udhëzimet Metodologjike dhe Organizative dhe të jenë të përgatitur për të praktikuar në terren bazuar në udhëzimet për grumbullimin e të dhënave të arsimit;
- Të zhvillojnë grumbullimin e të dhënave për arsimin para universitar në shkollat serbe përmes pyetësorëve;
- Të shpërndajë pyetësorët në shkollat serbe dhe t'i jep udhëzime personelit për plotësim;
- Të zhvillojë kontakte me personelin e angazhuar për plotësim të pyetësorëve lidhur me mbarëvajtjen e plotësimit të pyetësorit;
- Të vizitoj shkollat për të dytën herë për të marrë pyetësorin e plotësuar;
- Para largimit nga shkolla të bënë kontrollimin e pyetësorit të plotësuar për t'u siguruar se të gjitha pyetjet janë plotësuar dhe të gjitha udhëzimet janë ndjekur;
- Përdorimi i adresarëve për shkollat ;
- Të njoftojnë mbikëqyrësit për problemet dhe pasiguritë e mundshme dhe të kërkoj ndihmë nëse është e nevojshme;
- Intervista zhvillohet në gjuhën të cilën e flasin ai komunitet;
- Të bëjnë raportimin javor te mbikëqyrësi (zyra rajonale);
- Të përfundojë pyetësorët brenda afatit;
- Të mbajë të gjitha informatat e pranuar nga shkollat si sekret zyrtar;
- Të sjellë në ASK pyetësorët e plotësuar pas përfundimit të punës në terren;

### **Përgatitja shkollore/përvoja:**

- Të kenë të kryer shkollën e mesme.
- Përparësi kanë personat që kanë që kanë marrë pjesë së paku në një anketë ;

### **Kompetenca dhe aftësitë:**

- Aftësi dhe bashkëpunim shumë të mirë për të komunikuar;
- Të jenë të gatshëm për punë ekipore;
- Aftësi të orientimit në hapësirë;
- Të ketë aftësi të mira organizative;
- Të jetë nga rajoni përkatës ku kërkohet;

### **Kushtet e pjesëmarrjes në konkurs:**

Të drejtë aplikimi kanë të gjithë Qytetarët e Republikës së Kosovës të moshës madhore të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, janë në posedim të drejtave civile dhe politike, kanë përgatitjen e nevojshme arsimore dhe aftësinë profesionale për kryerjen e detyrave dhe të cilët kanë aftësitë fizike që kërkohen për pozitën përkatëse.

### **Aktet ligjore dhe nënligjore që e rregullojnë rekrutimin:**

Përzgjedhja bëhet në pajtim me nenin 12 paragrafi 4 të Ligjit Nr. 03/L-149 të Shërbimit Civil të Republikës së Kosovës, Ligjin Nr. 04/L-077, Për Marrëdhëniet e Detyrimeve. Në këtë konkurs zbatohet një procedurë e thjeshtësuar e rekrutimit.

### **Procedurat e konkurrimit:**

Procedura e konkurrimit është e hapur për kandidatët e jashtëm.

### **Konkursi është i hapur 8 ditë kalendarike nga dita e publikimit në mjetet e informimit dhe në Web-faqen e ASK-së.**

Numri i anketuesve sipas etnitetit dhe regjionit:

1 anketues i nacionalitetit serb në regjionin e Gjilanit dhe

1 anketues i nacionalitetit serb në regjionin e Ferizajt.

**Paraqitja e kërkesave:** Formularët për aplikim mund të merren në Arkivin e ASK-së, ose mund të shkarkohet nga web faqja e ASK-së në adresën <http://ask.rks-gov.net/> Aplikacionet merren dhe dorëzohen në Agjencinë e Statistikave të Kosovës, Rr,"Zenel Salihu" nr.4 Prishtinë.

**Aplikacionit duhet t'i bashkëngjiten:** CV<sup>1</sup>, kopja e letërnjoftimit, dokumenti mbi vendbanimin, diploma e shkollës së mesme ( të gjitha dokumentet duhet të jenë kopje).

Aplikacionet e dërguara me postë, të cilat mbajnë vulën postare mbi dërgesën e bërë ditën e fundit të afatit për aplikim, do të konsiderohen të vlefshme dhe do të merren në shqyrtim nëse arrijnë brenda 2 ditësh, aplikacionet që arrijnë pas këtij afati dhe aplikacionet e mangëta refuzohen.

Kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të ftohen në intervistë nëpërmjet telefonit dhe do t'i nënshtrohen testit me gojë.

Agjencia e Statistikave të Kosovës, mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore, nga të gjitha komunitetet.

Për informata të hollësishme, mund të kontaktoni në zyrën e personelit, në tel: 038- 200 31 149 apo 038-200 31 140 prej orës 08:00 – 16: 00.

---

<sup>1</sup> Përfshi: Nr. Telefonit si dhe një adrese elektronike